



FORUMI Shqiptar Liqeni Shkodres

1. Informacion Bazë

- Viti i Themelimit: 2008
- Statusi Ligjor: Organizatë Joqeveritare,
- Selia Qendrore: Sheshi 2 Prilli, Rr. Studenti, Nr 2, Shkoder, Shqiperi
- Faqja e Internetit: <https://discovernorthernalbania.com>
- Email kryesor i organizatës: transboundary.forum@gmail.com
- Telefoni kryesor i organizatës: +355 (0)2224 1877

2. Misioni

FSLs ka mision të kontribuojë në qëndrueshmëri dhe transparencë për mbrojtjen e burimeve natyrore, duke zbatuar projekte që ndërtojnë qëndrueshmëri në ruajtjen e natyrës, që promovojnë & adresojnë zgjidhje, që përkrahin lëvizshmërinë e qëndrueshme dhe zhvillojnë kapacitetet për qeverisjen mjedisore në nivel lokal, kombëtarë dhe ndërkufitarë

3. Vizioni (Opsionale)

Një Shqipëri dhe rajon ndërkufitar ku burimet natyrore mbrohen me qëndrueshmëri dhe transparencë, duke fuqizuar qeverisjen mjedisore dhe duke frymëzuar komunitete të ndërgjegjshme për një të ardhme të gjelbër.

4. Fushat Kryesore të Fokosit

- Mbrojtja dhe Ruajtja e Burimeve Natyrore
- Qeverisja Mjedisore dhe Ndërtimi i Kapaciteteve
- Ndërtimi i qëndrueshmërisë ndaj ndryshimeve klimatike.
- Advokimi për Politika mjedisore

5. Aktivitetet/Programet Kryesore

PROJEKTI 1. Titulli i Projektit: Skica e Planit të Menaxhimit për Rezervën e Biosferës së Rajonit të Liqenit të Shkodrës.

Financuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Agjencia Kombetare e Zonave të Mbrojtura. Projekti kishte në fokus hartimin e Planit të menaxhimit të Liqeni I Shkodres sipas parimeve të Programit Njeriu dhe Biosfera (MAB) të UNESCO-s, i cili mbështet promovimin e zhvillimit të qëndrueshëm duke integruar ruajtjen e biodiversitetit, ruajtjen e trashëgimisë kulturore dhe strategjitë e menaxhimit të bazuara në komunitet.

Ky projekt është zbatuar brenda iniciativës më të gjerë të krijimit të rajonit të Liqenit të Shkodrës si Rezervë Ndërkufitare e Biosferës (TBR). Plani mishëron përpjekjet bashkëpunuese të Shqipërisë dhe Malit të Zi dhe udhëhiqet nga marrëveshjet ndërkombëtare, duke përfshirë Konventën Ramsar dhe Konventën për Diversitetin Biologjik (CBD), ndërsa është gjithashtu në përputhje me direktivat mjedisore të Bashkimit Evropian. Një projekt i tillë ndërkufitar synon të forcojë qeverisjen mjedisore,



FORUMI Shqiptar Liqeni Shkodres

të përmirësojë strategjitë e ruajtjes dhe të promovojë shfrytëzimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore.

PROGRAMI 2 ADRION (36 mujor). Titulli i Projektit: **Nxitja e Praktikave më të mira për të përmirësuar mbrojtjen transnacionale të integritetit dhe shërbimeve të ekosistemeve**. [IMPRECO-PC: 450]. Financuar nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit përmes mbështetjes Financiare të BE / programi ADRION. Projekti kishte në fokus nxitjen e shërbimeve të ekosistemit dhe trajtimin e cenueshmërisë së tyre mjedisore. Përmes hartëzimit të zonave me ndjeshmëri të latë projekti synon ruajtjen e potencialit të biodiversitetit nëzonën e mbrojturpilot (për Shqipërinë) Liqeni i Shkodrës dhe ekspozimin e praktikave trans-nacionale për ndërtimin e një metodologjie dhe strategjie për ruajtjen e EkoSistemeve.

PROJEKTI 3. Titulli i Projektit: Te Rinjte për një të Ardhme më të Mirë në Shqipërinë e Veriut. Shtator 2024 – Gusht 2025. Financuar nga British Council Albania. Ky projekt ka si qëllim fuqizimin e të rinjve (15-19 vjeç) në pesë gjimnaze të bashkive Kukës, Mat, Malësi e Madhe, Lezhë dhe Shkodër. Përmes angazhimit aktiv në trashëgiminë kulturore, projekti synon të zhvillojë aftësitë e tyre krijuese dhe sipërmarrëse, si dhe të kultivojë të menduarin kritik, të cilat janë mjete thelbësore për të përballuar sfidat e së ardhmes dhe për të arritur qëllimet profesionale. Për të nxitur aftësimin e të rinjve në Veri të Shqipërisë, projekti e ka vendosur trashëgiminë kulturore si gur themeli dhe një rrugë alternative për gjenerimin e sipërmarrjeve. Angazhimi i të rinjve me traditat e tyre forcon lidhjet me komunitetin dhe u mundëson atyre të trashëgojnë historinë, traditat dhe pasuritë natyrore të Veriut, duke i shërbyer si bazë për zhvillimin e qëndrueshëm të rajonit në të ardhmen. Për më shumë informacion, klikoni: <https://www.facebook.com/share/v/19DVHRZyur/>

PROJEKTI 4. Titulli i Projektit: Veriu i Shqipërisë i Portretizuar nga Autorët e Shekullit XVIII. Janar 2023 – Qershor 2024. Projekti u përqendrua në diversifikimin e ofertës turistike në Shqipërinë e Veriut. Duke shfrytëzuar narrativat, përshkrimet dhe dokumentimet e diplomatëve dhe autorëve të shquar të shekullit XVIII, projekti zhvilloi itinerare turistike të emërtuara sipas këtyre autorëve. Njëkohësisht, projekti mundësoi rritjen e kapaciteteve të operatorëve dhe bizneseve lokale, duke i trajnuar mbi Kriteret e Këshillit Global të Turizmit të Qëndrueshëm (GSTC) për Destinacionet Turistike të Qëndrueshme dhe indikatorët e performancës. Për më shumë informacion, vizitoni: <http://discovernorthernalbania.com>. Mbështetur nga: HELVETAS Swiss Cooperation / RisiAlbania

PROJEKTI 5. Titulli i Projektit: Lëvizja Rinore "Qyteti Im Ekologjik". Projekti synoi të nxisë dhe mbështesë lëvizjen e të rinjve drejt qyteteve ekologjike dhe një cilësie më të mirë jetese, duke i pozicionuar ata si palë interesi kyçe për të siguruar burime cilësore për brezat e ardhshëm. Projekti angazhoi të rinjtë në nisma inovatore për qytete me mjedis të pastër, gjë që kulminoi në një panair idesh të gjelbra. Idetë më të mira u prezantuan në Këshillin Bashkiak të Bashkisë Shkodër. Të rinjtë pjesëmarrës u mbështetën me trajnime dhe mentorim për prodhimin e maketeve dhe modeleve, të cilat edhe sot gjenden të ekspozuara në sallën e takimeve të Këshillit Bashkiak të Shkodrës. Për më shumë informacion, ndiqni: <https://ëëë.youtube.com/ëatch?v=LF-MbFtG76A> Financuar nga Programi GreenAL, me fonde të Qeverisë Suedeze (SIDA) dhe zbatuar nga Co-PLAN në bashkëpunim me CISP VIS Albania dhe COSV.

PROJEKTI 6. Titulli i Projektit: FOL për ATA që HESHTIN. Ky projekt u përqendrua në nxitjen e lëvizjes qytetare për mbrojtjen e Lumit Buna nga ndotja me ujëra të zeza, duke përdorur mekanizma ligjorë



FORUMI Shqiptar Liqeni Shkodres

dhe denoncimin e krimit mjedisor. Përmes një monitorimi tremujor, projekti hartoi një raport monitorimi, i cili, së bashku me një peticion qytetar me 2700 firma, iu dërgua autoriteteve më të larta qendrore, rajonale dhe vendore. Kërkesa ishte marrja e masave urgjente për ndalimin e shkarkimeve të patrajtuarra të ujërave të zeza në Lumin Buna. Projekti arriti rezultate të prekshme, duke ndaluar shkarkimet në Lumin Buna. Financuar nga Swiss Cooperation përmes programit LevizAlbania.

PROJEKTI 7. Titulli i Projektit: KILOMETRI I GJELBËR – Buna: Një Destinacion Turistik Tërheqës që Promovon Vlerat Natyrore! Projekti synoi të promovonte zonën e mbrojtur të Lumit Buna si një destinacion i aksesueshëm për zhvillimin e qëndrueshëm lokal, nëpërmjet vlerave të saj ekoturistike. Në kuadër të këtij projekti, u krijuan shtigje ekoturistike të qëndrueshme, si dhe u ngrit një brez i gjelbër me frashër të bardhë, një bimë endemike në rrezik. Gjithashtu, projekti kontribuoi në ndërtimin e kapaciteteve ekoturistike përgjatë Lumit Buna. Qershor 2021 – Korrik 2022. Financuar nga Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile.

PROJEKTI 8. Titulli i Projektit: “Diversiteti Biologjik për Zhvillimin e Qëndrueshëm Lokal - Plan Veprimi” [PC: R1-39] Financuar nga BE përmes programit EcoNord. Projekti kishte në fokus: Nxitjen e grupeve të interesit/ përdoruesit të burimeve natyrore (end users) në njohjen dhe planifikimin e përdorimit të zgjuar të burimeve natyrore; rritjen e vetëdijes qytetare mbi biznesin e gjelbër dhe gjenerimin e të ardhurave bazuar në traditën lokale. Projekti siguroj qëndrueshmërinë përmes hartimit të: “Plani i veprimeve për zhvillimin e qëndrueshëm lokal” miratuar me vendim të këshillit bashkiak Nr. 16, datë 01/03/2017

PROJEKTI 9: Titulli i Projektit: “Ekosisteme të shëndetshëm – Njerëz të shëndetshëm” - Ekspozitë e habitateve të kërcënuara të Liqenit të Shkodrës. [PC: L17527] Financuar nga IUCN & JITCA.

Projekti kishte në fokus: Lëvizje studentore për ndryshimin e sjelljes në MJEDIS. Forcimi i bashkëpunimit mes grupeve komunitare, autoriteteve vendore dhe Organizatave të Shoqërisë Civile për adresimin e kërcënimeve në mjedis dhe monitorimin e zbatimit të konventës RAMSAR kundrejt gjuetisë së jashtëligjshme dhe përdorimit të mjeteve të jashtëligjshme të peshkimit.

PROGRAMI 10: SENiOR–A. Titulli i Projektit: “Zhvillimi i kapaciteteve lokale për mbrojtjen efektive të burimeve natyrore” (4 vjecare)

Objektivi kryesor i këtij projekti ishte forcimi i rolit të Organizatave të Shoqërisë Civile (OSHC) në mbrojtjen e natyrës dhe rritja e kontributit të tyre në menaxhimin e integruar të Zonave të Mbrojtura. Projekti u përqendrua në disa drejtime kyçe:

- Forcimin e rolit dhe rritjen e dukshmërisë aktive të OShC-ve në rrjetin kombëtar.
- Promovimin e OShC-ve si partnerë kryesorë të institucioneve në adresimin e prioriteteve kombëtare, si në nivel lokal, rajonal, ashtu edhe kombëtar.
- Nxitjen e bashkëpunimit ndërmjet OShC-ve përmes shkëmbimit të përvojave të përbashkëta mes anëtarëve të rrjetit.

Projekti siguroi qëndrueshmërinë e këtyre përpjekjeve përmes monitorimit, hartëzimit dhe hartimit të dokumentit të zonave kritike në nivel kombëtar, si dhe identifikimit të ndikimeve negative të unifikuara në Zonat e Mbrojtura. Raporti i monitorimit të zbatimit të politikave në nivel kombëtar dhe lista e zonave të kërcënuara iu dërguan Ministrisë të Turizmit dhe Mjedisit, Komisionit Parlamentar të Veprimtarive Prodhuese dhe Mjedisit, si dhe 16 kryetarëve të bashkive të përfshira në projekt.



FORUMI Shqiptar Liqeni Shkodres

PROGRAMI 11: Menaxhimi i Integruar i Liqenit të Shkodrës / Skadar. Fushatë Publike Vetëdije në Shqipëri dhe Mal të Zi mbi vlerat ekonomike, kulturore, sociale, turistike dhe historike të ekosistemit të përbashkët Lumi Buna – Liqeni i Shkodrës.

Ky projekt synonte nxitjen e menaxhimit të integruar ndërkufitar të Liqenit të Shkodrës. Ai kishte për qëllim përmirësimin e shërbimeve për menaxhimin e burimeve natyrore në rajon dhe zhvillimin e komuniteteve lokale për të rivitalizuar vlerat tradicionale të zonës. Njëkohësisht, projekti u fokusua në shkëmbimin e praktikave më të mira ndërkufitare në menaxhimin e burimeve të përbashkëta ujore. Përmes kësaj, autoritetet shqiptare të menaxhimit patën mundësinë të shkëmbejnë përvoja mbi menaxhimin trilateral të Liqenit të Bodenit (Zvicër-Austri-Gjermani) dhe menaxhimin e Liqeneve të Mëdha (SHBA – Kanada). Barazia gjinore u promovua si një çështje horizontale dhe një prioritet për integrimin gjinor në trajtimin e shqetësimeve mjedisore.

Projekti u përqendrua në nivel ndërkufitar, me theks në:

- Promovimin e Sekretariatit të Përbashkët dhe Grupeve të Përbashkëta të Punës Teknike mes Shqipërisë dhe Malit të Zi, vende që ndajnë burime të përbashkëta.
- Organizimin dhe promovimin e ngjarjeve të përbashkëta në të dyja palët.
- Prodhimi dhe shpërndarja e informacionit për komunitetin mbi rëndësinë e burimeve natyrore të Liqenit të Shkodrës, duke rritur ndërgjegjësimin për vlerat e tyre dhe përdorimin e qëndrueshëm.
- Promovimin e trashëgimisë kulturore dhe zhvillimin e qëndrueshëm të turizmit në rajonin e Liqenit të Shkodrës.

6. Shtrirja Gjeografike

Organizata shtrin veprimtarinë e saj në nivel kombëtar. Veprimtaria e saj është më intensive në veri të Shqipërisë, veçanërisht në bashkitë: Shkodër, Malësi e Madhe, Pukë, Vau i Dejës, Fushë Arrëz, Mat, Lezhë dhe Kukës. Gjithashtu, Forumi Shqiptar i Liqenit të Shkodrës zhvillon veprimtari në Tiranë, Pogradec dhe Elbasan. Përtej nivelit kombëtar, organizata shtrin veprimtarinë e saj edhe në nivel ndërkufitar në Mal të Zi, më konkretisht në Podgoricë, Cetinjë, Ulqin dhe Krajë.

7. Udhëheqja

Drejtori Ekzekutiv/CEO: Djana BEJKO

Bordi i Drejtuesve: Atrida Ferketi, Ridvan Sokoli, Ermira Limani, Bresena Kopliku, Flora Gjoni

8. Partneritetet dhe Bashkëpunimet (Opsionale)

Organizata jonë gëzon një rrjet të gjerë partneritetesh dhe bashkëpunimesh, si në nivel kombëtar, ashtu edhe ndërkombëtar. Në këtë kuadër, kemi zhvilluar dhe zbatuar projekte e programe me ndikim pozitiv në shkallë kombëtare dhe rajonale.

Ndër donatorët dhe bashkëpunëtorët tanë kryesorë përfshihen:

- Banka Botërore / GEF
- Ministria e Mjedisit dhe Turizmit (AKZM)
- HELVETAS Swiss Cooperation
- Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC)
- Co-PLAN, Instituti për Zhvillimin e Habitatit



FORUMI Shqiptar Liqeni Shkodres

- REC Albania
- Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC)
- British Council Albania
- Universiteti "Luigj Gurakuqi"
- Bashkitë Shkodër, Malësi e Madhe dhe Lezhë
- Risi Albania
- Leviz Albania

9. Ndikimi (Opsionale)

Iniciativat dhe rezultatet më domethënëse, të cilat kanë pasur një ndikim të prekshëm në komunitet dhe mjedis janë:

- **Fushata e suksesshme për Mbrojtjen e Shëndetit Publik, Lumit Buna dhe Ekosistemit të Liqenit të Shkodrës:** Kemi udhëhequr një fushatë të fuqishme avokimi, duke mbledhur 2,500 firma peticionesh dhe duke përcjellë një mesazh të qartë dhe të fuqishëm tek vendimmarrësit kryesorë. Këtu përfshihen Kryeministri i Shqipërisë, Ministri i Mjedisit dhe Turizmit, Kryetari i Bashkisë Shkodër, Këshilli Bashkiak i Shkodrës dhe Prefekti i Qarkut Shkodër, duke theksuar rëndësinë e mbrojtjes së këtij ekosistemi jetik.
- **Përmirësimi i Kurrikulës për Guida Lokale dhe Menaxherët e Turizmit (Shqipëria e Veriut):** Kemi rinovuar thellësisht kurrikulën e këtij programi profesional njëvjeçar në Universitetin Luigj Gurakuqi. Qëllimi ynë ishte t'i pajisim të diplomuarit me aftësitë dhe njohuritë e nevojshme për të performuar shkëlqyer si guida lokale dhe menaxherë turizmi, me një theks të veçantë në rajonin e Shqipërisë së Veriut.
- **Krijimi i Vendeve të Punës për Guida Lokale:** Përmes iniciativës "Rizbulojmë Shqipërinë e Veriut nëpërmjet Shkrimtarëve të Shekujve XVIII – XXI", kemi mundur krijimin e dy vendeve të reja pune për guida lokale në Shqipërinë e Veriut, duke mbështetur zhvillimin ekonomik lokal dhe promovimin e trashëgimisë kulturore.
- **Konceptet e Gjelbra për Qytete Ekologjike nga Rinia:** Të frymëzuar nga iniciativa "Qyteti IM Ekologjik" të rinj nga këshillat bashkiakë të Shkodrës, Malësisë së Madhe dhe Lezhës kanë hartuar dhe prezantuar një set bindës prej 20 konceptesh të gjelbra. Këto ide inovative do të shërbejnë si udhërrëfyes për zhvillimin e qyteteve më miqësore me mjedisin në rajonet e tyre përkatëse.
- **Nga aktiviteti i organizates:** Vetëm gjatë tre viteve të fundit, organizata ka shënuar arritje të rëndësishme, duke ndikuar pozitivisht në komunitet dhe mjedis. Ne kete kontekst:
 - Kemi angazhuar mbi 5,000 pjesëmarrës në aktivitetet tona, nga të cilët 3,170 janë gra dhe vajza. Ky angazhim i gjerë dëshmon ndikimin tonë në rritjen e pjesëmarrjes komunitare.
 - Kemi trajnuar tematikisht mbi 120 aktorë të ndryshëm, duke u dhënë atyre njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për të kontribuar në fushat përkatëse.
 - Në kuadër të nismave tona mjedisore, janë mbjellë 1,000 fidanë, duke kontribuar në gjelbërimin dhe mbrojtjen e ekosistemit.
 - Kemi influencuar me sukses 3 politika në nivel vendor dhe 2 politika në nivel kombëtar, duke sjellë ndryshime konkrete dhe afatgjata në favor të komunitetit dhe qëllimeve tona.

10. Lajmet e Fundit/Çmimet (Opsionale)



FORUMI Shqiptar Liqeni Shkodres

- **TV - Radio Televizioni Shqiptar:**
<https://www.facebook.com/rtshshkodra.live/videos/1178720186995259>
- **TV Star Plus – Emisioni Info+**
<https://www.youtube.com/watch?v=u79SdjKX78M>
- **Bashkia Malesi e Madhe**
<https://www.facebook.com/share/p/dKoqLLf9MQNVb4q1/?mibextid=WC7FNe>
- **TV1 Channel – Shkodër**
<https://www.facebook.com/tv1channelshkoder/videos/206186428988749>
- **TV – Zeri i Amerikes (VoA)**
https://www.zeriamerikes.com/a/6985226.html?fbclid=IwY2xjawLR6JZleHRuA2FlbQIxMQBicmlkETF0a1N3YW9rbGJpbVNpeTRNAR6BxkuTj_VjXqrUxobPp9Xm1sBSa4ikxUnbeYD1ExA3gZgWiW97JJtipFG6KQ_aem-zlWlmin_U8pdrOEEeQxA